



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:082027

Datë: 05.06.2024

Numri i dokumentit: 05786658

KE.nr. 1653/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen juridike të paditësit/propozuesit të sigurimit “Gashi Invest” me nr. të biznesit 7122270 dhe me seli në Lipjan, rr. “Tahir Sinani” p.n., që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Ekrem Agushi me zyre në Prishtinë, kundër të paditurit/kundërshtarit të sigurimit “XIMI” Sh.P.K., me nr. të biznesit 810097768 dhe me seli në Lipjan, jashtë seancës gjyqësore, me datë 05.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar padia dhe propozimi për caktimin e masës së sigurimit e ushtruar nga paditësi/propozuesi i sigurimit “Gashi Invest” kundër të paditurit/kundërshtarit të sigurimit “XIMI” Sh.P.K, me objekt kontesti shpallje e pavlefshme e urdhrit përmbarrimor P.nr. 20/20 të datës 17.07.2020 të lejuar nga Përmbarruesi Privat Isak Islami.

A r s y e t i m

Paditësi Gashi Invest, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 28.04.2021 ka paraqitur padi së bashku me propozim për masë të sigurisë, ndaj të paditurit/kundërshtarit të sigurimit “XIMI” Sh.P.K., duke kërkuar shpalljen e palejueshme të urdhrit përmbarrimor P.nr. 20/20 dt. 17.07.2020 të lejuar nga Përmbarruesi Privat Isak Islami.

Në arsyetimin e padisë ka theksuar se i padituri, në cilësinë e kreditorit ka iniciuar procedurë përmbarrimore ndaj paditësit në cilësi të debitorit, ku Përmbarruesi Privat, përmes urdhrit P.nr. 20/20 të datës 17.07.2020 ka lejuar përmbarrimin dhe ka detyruar këtu paditësin që t’ia paguaj borxhin nga faturat nr. 8/19 e datës 29.05.2019 dhe nr. 25.06.2019 dhe faturës nr. 12/19 e datës 08.07.2019 në shumë të përgjithshme prej 11,967.00 EUR. Ka shtuar se urdhri përmbarrimor i përmbarruesit privat nuk mund të krijoj efekte juridike dhe si i tillë duhet shpallur si i pavlefshëm,

kjo pasi që paditësi, i ka përmbushur obligimet ndaj të paditurit në rrugë jashtë gjyqësore. Andaj, në kuptim të nenit 260 par.4 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, ka kërkuar nga gjykata që të shpallët i pavlefshëm urdhri përmbartimor P.nr. 20/20 i datës 17.07.2020 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isak Islami dhe të detyrohet i padituri që t'ia paguaj paditësit shpenzimet e procedurës. Ndërsa, me propozimin për masë të sigurisë, ka kërkuar që të ndalohet i padituri/kundërshtari i sigurimit që të realizoj kërkesën sipas urdhrit përmbartimor.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit së bashku me propozimin për caktimin e masës së sigurimit, gjeti se e njëjta është e palejuar, andaj si e tillë duhet hudhur, kjo për shkaqet në vijim:

Me Ligjin nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje: LPP), nenin 67 paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbartimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa,”* ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbartimore. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimi dhe ankesës kundër vendimeve të përmbartueshëm për përmbartimin me dhunë.”*

Meqenëse në rastin konkret kërkesa sipas padisë dhe propozimit për caktimin e masës së sigurimit është paraqitur ndaj urdhrit përmbartimor P.nr. 20/20 të datës 17.07.2020 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Isak Islami, gjykata vlerëson se kërkesat në fjalë janë të palejuara për faktin se sipas LPP-së, është përcaktuar qartë se ndaj urdhrit për lejimin e përmbartimit parashihet ushtrimi i mjeteve të rregullta juridike, apo eventualisht propozimi për kundër përmbartim nga neni 54 i LPP-së, mirëpo me asnjë dispozitë ligjore nuk është përcaktuar e drejta e paraqitjes së padisë apo masës së sigurimit ndaj urdhrit për lejimin e përmbartimit, andaj si rrjedhojë i njëjti nuk mund të gëzojë mbrojtje juridike në këtë procedurë.

Në anën tjetër, referimi i paditësit në nenin 260 par.6 të LPP-së si bazë për ngritjen e padisë është i paqëndrueshëm, kjo për faktin se nga dispozita e lartcekur përcaktohet se *“Personi të cilit i është kontestuar kredia, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit që i është shkaktuar me kontestim të paarsyeshëm të kredisë së tij, po qe se një gjë e tillë i është bërë vetëm me qëllim që t'i shkaktohet dëmi, ose që të pengohet në realizimin e të drejtave të tija”*. Kësisoj, dispozita në fjalë i referohet rasteve kur në procedurë përmbartimore paraqitën dy apo më shumë palë në anën e kreditorit, ashtu që njëra palë kreditore, paraprakisht, përmes padisë e ka kontestuar kredinë e

palës tjetër kreditore dhe i cili kontestim i kredisë ka qenë i paarsyeshëm, ashtu që palës tjetër kreditore i është shkaktuar dëm në realizimin e të drejtës së tij ndaj debitorit të përbashkët.

Rrjedhimisht, e drejta për paraqitjen e padisë sipas nenit 260, par.6 i njihet vetëm palës kreditore të cilës i është pamundësuar realizimi i kredisë ndaj debitorit, kjo si rezultat i një padie të pasuksesshme të iniciuar paraprakisht nga pala tjetër kreditore, e që nuk rezulton të jetë në rastin konkret.

Nga sa u tha më lartë dhe në kuptim të nenit 391 par a) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 1653/22, datë 05.06.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.